



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

NJOFTIM

**PËR ZGJATJEN E AFATIT PËR SHPALLJEN E SHPREHJES SË INTERESIT NGA ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE / MBROJTËSIT E TË DREJTAVE TË NJERIUT, PËR TË QENË PJESË E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR KOMISIONER NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT**

*Të nderuar përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile/Mbrojtës të të drejtave të njeriut!*

Në zbatim të nenit 33/1, pika 4 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit ka shpallur konkurimin për 2 (dy) vende vakant për Komisioner dhe konkretisht:

- ✓ *Komisioner në Seksionin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve*
- ✓ *Komisioner në Seksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimin të Egër, Ç’njerëzor ose Poshtëruës*

Duke pasur parasysh që procesi i përzgjedhjes për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për Komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit organizohet në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile apo mbrojtësit e të drejtave të njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit:

*Njofton zgjatjen e afatit të aplikimit deri më datë **05.01.2022** dhe i bën thirrje të gjithë individëve/ organizatave që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të cilat lidhen me fushën e veprimtarisë së Seksioneve përkatëse, të shprehin interesin e tyre për të qenë pjesë e këtij procesi përzgjedhjeje, përmes konfirmimit në adresën elektronike: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al).*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin e vazhdueshëm!